



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit

02.nr. 6482/2020

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës, Ligjit të Prokurimit Publik nr. 04/L042, Neni 58, 59, Statutit të komunës Hani i Elezit neni 23.3 dhe neni 56, Marrveshjen e grantit me numër 414/194/2019, programin për bashkëpunim ndërkufitar IPA II 2014 – 2020, ndërmjet Komunës së Hanit të Elezit dhe Komunës së Gazi Babës, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

1. Merret vendim për formimin e komisionit për hulumtim të tregut dhe vlerësimin e procedurave për dhënien e kontratave për punimet e ndërtimit të projektit “Kanali i Mbyllur” në fshatin Seçishtë, komuna Hani i Elezit.
2. Ky komision për hulumtim të tregut dhe vlerësim i procedurave për dhënien e kontratave (punimet e ndërtimit) bëhet në bazë të ligjit të Prokurimit Publik për projektin “Kanali i Mbyllur”.
3. Komisioni përbëhet nga pesë anëtar, siç vijojnë:
 - Musafer Dernjani - Kryetar i Komisionit pa të drejtë vote
 - Amir Qajani - Sekretar i Komisionit pa të drejtë vote
 - Xhevdet Bushi - Anëtar i Komisionit me të drejtë vote
 - Durim Dernjani - Anëtar i Komisionit me të drejtë vote
 - Bajrush Laqi - Anëtar i Komisionit me të drejtë vote
4. Komisioni obligohet të zbatojë të gjitha fazat e parashikuara në përputhje me Marrveshjen e Dhënies së Grantit nr.2019/414-194, dhe Udhëzuesit Praktik Kontraktual për Veprimet e Jashtme të Bashkimit Evropian (PRAG – korrik 2019) si me poshtë: hulumtimi i tregut,



shpallja e procedurës së tenderit, hapja e ofertave, mbajtja e procesverbalit, përcaktimi i operatorëve ekonomik, kontrollimi teknik dhe ofertat financiare të paraqitura nga ofertuesit në lidhje me kushtet dhe kërkesat specifike teknike / detyrës së projektit, llogaritjes së shumës përcaktimit të ofertave të pranueshme dhe të papranueshme dhe propozimin për ofertën më të favorshme.

5. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit.

Data: 14.09.2020
Hani i Elezit

